



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPK/OMP
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	03-3275/13
Nr. i tag. Bvojstranica Nr. pages	02
Data Datum Date	11.10.2013



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA
KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

Nr Regj.14850/2012

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PERGJITHSHËM, Divizioni i Kundërvajtjes, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Naim Zeqiri nga Prishtina, për kundërvajtje nga neni 8 paragrafi 1 e ndëshkuar sipas nenit 17 par 1 .1. të Ligjit nr. 04/L-050, të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave, për të gjithë personat Zyrtar, e në bazë të nenit 73,74,195, 199, të LMK me dt. 02.10.2013. merr këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI : Naim Rexhep Zeqiri, i lindur më 28.11.1978 në Prishtinë, ku dhe tani jeton. në rrugën “Velania 7”, nr. 19, udhëheqës i Zyrës për komunikim në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, i gjendjes së mesme ekonomike.

Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s

Sepse, i pandehuri në cilësinë e Zyrtarit të Lartë Publik, udhëheqës i Zyrës për komunikim Publik në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, nuk e ka deklaruar gjendjen e pasurisë, i cili bëhet me deklarin e rregullt të paraparë me ligj, deri me datën 31.03.2012, të çdo viti kalendarik, në Agjencionin Kundër Korrupsionit.

Me këtë ka kryer vepër kundërvajtëse nga neni 8 paragrafi 1, e ndëshkuar sipas nenit 17 par 1 pika.1.1 të Ligjit nr. 04/L-050, për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë, të Zyrtarëve të Lartë Publikë dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave për të gjithë personat zyrtar, andaj për këtë:

D E N O H E T

Me gjobë në shumë prej 1000.-€ (njëmijëeuro). Gjobën e shqiptuar, i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merr formën e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së. No. 1000-4300-7000-0518.

Pagesa bëhet në ndonjërin Agjenci për mbledhjen e të hyrave –bankë, përmes urdhërpagesës të plotësuar në këtë Divizion. Nëse brenda afatit të caktuar, i pandehuri nuk e paguan gjobën, e njëjta do ti zëvendësohet me dënim burgimi, në kohëzgjatje prej 30 (tridhjetë) dite, duke llogaritur 20.-€ (njëzet euro) në një ditë burgu.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit, i pandehuri është i obliguar të paguaj shumën prej 5.-€ (pesë euro), në afat të njëjtë sikurse gjobën në shërbimin e arkës së këtij Divizioni.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dorëzohet të pandehurit dhe ushtruesit të kërkesës.

A r s y e t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit, parashtroi kërkesën nr. 01 -1604/2012 të dt. 30.04.2012, për fillimin e procedurës kundërvajtëse, kundër të pandehurit të përmendur më lartë, për kundërvajtje të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke propozuar të shpallet përgjegjës dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjyqtari në shkallë të parë, me dt. 17.10.2012, ka marrë aktvendim me të cilin shpallë përgjegjës dhe e dënon me dënim me gjobë në shumë prej 1000.-€ (njëmijë euro). Kundër këtij aktvendimi i pandehuri Naim Zeqiri, ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Lartë për kundërvajtje. Gjykata e Lartë me aktvendimin GJL. nr. 1298/12 dt. 23.11.2012, ka aprovuar ankesën e palës si të bazuar, ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e ka kthyer në plotësim të procedurës dhe rivendosje, që të merren edhe këto veprime: të dëgjohet përfaqësuesi i kërkesës së ushtruar, i pandehuri si dhe zyrtari i arhivës.

Duke vepruar sipas konstatimeve dhe vërejtjeve të theksuara më lartë, u dëgjua i pandehuri Naim Zeqiri, i cili deklaroi se, sa i përket plotësimit të formularit për deklarin e pasurisë së rregullt vjetore, unë e kam pranuar me kohë nga personeli i Ministrisë, të cilin e kam plotësuar dhe ia kam dorëzuar në arhivë të Ministrisë, personit me emrin Arben, me qëllim që ai ta dorëzoi në Agjencion, pasi që unë me dt. 28.03.2012, deri me dt. 04.04.2012, kam qenë në vizitë zyrtare në Tiranë dhe pas kthimit nga vizita, e kam pyetur arkivistin se pse nuk e ka dorëzuar formularin, i njëjti është arsyetuar se, formulari duhej të dorëzohet personalisht nga ju në Agjencion dhe me dt. 12.04.2012, unë e kam dorëzuar personalisht formularin me të dhënat e pasurisë sime në Agjencion, i cili në mënyrë elektronike në web faqen e tij, ka publikuar se, unë kam plotësuar formularin për deklarin të pasurisë, ndërsa në anën tjetër ky Agjencion, bën kërkesë për mosdeklarim të pasurisë sime, gjendje kjo, e cila nuk e di se a jam person që kam deklaruar pasurinë time apo nuk e kam deklaruar, si dhe kërkoj që të sqarohen rrethanat e nenit 11 të Ligjit mbi kundërvajtje, e cila përcakton edhe gjendjen e lëndës time, pasi që unë e kam përbushur obligimin duke deklaruar pasurinë, para se të merret aktvendimi.

Sa i përket arkivistit, i pandehuri, gjykatës nuk mund t'ia siguroi emrin, mbiemrin si dhe adresën, por e merr përsipër që arkivistin ta sjell vet në afatin prej 8 ditësh, e i cili nuk e solli deri më tani.

U dëgjua edhe Përfaqësuesi i Agjensionit kundër Korrupsionit, Enis Sadiku, i cili deklaroi se, sa i përket kërkesës të cilën e kemi ushtruar ndaj Naim Zeqirit, ku sipas Ligjit nr. 04/050, shihet se deklaratimet janë paraparë në mënyrë taksative me ligj dhe në rastin konkret, kemi të bëjmë me deklaratim të rregullt vjetor, i cili është përcaktuar me nenin 8, i cili paraqet edhe kohën të cilët janë të obliguar ta paraqesin pasurinë prej dt. 01.03.2012 deri me dt. 31.03.2012 të çdo viti kalendarik, e i ndëshkuar sipas nenit 17 par.1 al.1.1 të këtij Ligji. Ne iu kemi dërguar formularët dhe njoftimet për plotësimin e këtyre formularëve, në bazë të listës të cilën e kemi marrë nga pikat e çdo Institucioni, ku në këtë listë ka qenë edhe emri i Naim Zeqirit.

Gjyqtari pasi që administroi provat dhe të provuarit e kësaj çështje, në mënyrë të drejtë dhe të plotë vërtetoi gjendjen faktike, duke e dëgjuar të pandehurin, parashtruesin e kërkesës si dhe provat e tjera të administruara nga shkresat e lëndës, në mënyrë bindëse u vërtetua se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen, duke e shpallë përgjegjës dhe e dënnon me gjobë si në diapozitiv të këtij aktvendimi.

Me rastin e shqiptimit të dënimit, Gjyqtari mori për bazë të gjitha rrethanat e parapara me nenin 7 të Ligjit mbi kundërvajtjet e posaçërisht peshën e kundërvajtjes së bërë, se edhe me këtë dënim, do të arrihet efekti pozitiv dhe se në të ardhmen do të shmangët nga kryerja e veprave të këtilla kundërvajtëse e të ngjashme.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA EHEMELORE PRISHTINË, DEPARTAMENTI I PERGJITHSHËM, Divizioni i Kundërvajtjes

GJYQTARI

Fatmir Beqirami

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi ankesë mund të ushtrojnë palët, Gjykatës së Apelit - Divizioni i Kundërvajtjes në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh prej datës së marrjes së këtij aktvendimi, nëpërmjet të këtij Divizioni.